

**AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
BLUE HORIZON CONSTRUCTION**

Neni 1 - Emri

1.1 Shoqëria krijohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është BLUE HORIZON CONSTRUCTION Shpk, më poshtë do të quhet “Shoqëria”.

Neni 2 - Themelimi

2.1 Shoqëria themelohet sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe fiton personalitet juridik me regjistrimin në Regjistrin Tregtare Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

2.2 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjin Shqiptar, me Statutin dhe Aktin e Themelimit.

Neni 3 - Selia

3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rr. Nazif Bezhani, Kati 1, Ap.1, Sarandë, Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të hapë ose të mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Shqipërisë.

Neni 4 - Ortaku i Vetëm

4.1 Ortaku i vetëm i Shoqërisë është:

- Znj. Liljana Selimi, shtetase shqiptar, lindur në Poliçan, më 29.06.1974, mbajtëse e letërnjoftimit nr. 036285509, me adresë në: Rr. Nazif Bezhani, Kati.1, Ap. 1, Sarandë.

Neni 5 - Kapitali Themeltar

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në shumën 1.000.000 (një milion) Lekë. Pra, kapitali themeltar i Shoqërisë është 1.000.000 (një milion) Lekë, qe përfaqësojnë 100% te kapitalit te Shoqërisë.

5.2 Kuotat, me vendim të Ortakut të Vetëm, janë lirisht të transferueshme tek çdo individ ose person juridik nëpërmjet kontratës se shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose nëpërmjet çdo mënyre tjetër të parashikuar nga ligji.

Neni 6 - Objekti

6.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin si më poshtë vijon:

- Ndërtimi i objekteve civile apo industriale dhe menaxhimi i zbatimit të projekteve të kësaj natyre. Ndërtim rrugësh, ndërtim vepra arti rrugore dhe/ose hekurudhore, ndërtime industriale, ndërtim ujësjellës dhe kanalizime, ndërtim vepra kullimi, ujitje e impiante vaditëse, punime mbrojtëse dhe sistemim i hidraulik lysterje te brendshme dhe te jashtme, izolime, termoizolime akustike, veprimtari për karpentier dhe pajisje teknologjike ne fusha te ndryshme, shfrytëzim i karrierve te gurit për prodhim inerte, cimento, prodhim betonesh, tullash etj. Ndërtime e rikonstruksione te ndryshme, te infrastruktures etj si dhe sistemit uJOR, punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh, veshje me asfalto beton te rrugëve, ndërtime mbi shtresa si dhe sistemim asfalti sheshesh, veshje fasadash. Marrje veprash ne koncesion nga qeveria për zhvillime te ndryshme, për zhvillime aktiviteti prodhues, industrial, turizëm, transport, etj. Import-eksport me shumice e pakice. Gjithashtu, Shoqëria mund te kryeje çdo lloj veprimtari apo transaksion tjetër qe lidhet me pasuri te luajtshme e te paluajtshme, me



kryerjen e veprime tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare te cfaredo lloji dhe natyre, te nevojshme ose te dobishme per arritjen dhe ose plotesimin e objektivit te Shoqërisë, qe nuk ndryshon aktivitetin paresor te Shoqërisë dhe nuk bie ne kundërshtim me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

6.2 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi, i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm.

Neni 7 - Kohëzgjatja

7.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 8 - Kompetencat e Ortakut të Vetëm

8.1 Ortaku i Vetëm, në përputhje me ligjet shqiptare, mund të marrë, por pa u kufizuar vetëm në to, vendime për ndryshimin e Statutit, bashkimin me shoqëri të tjera, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, transferimin e plotë ose të pjesshëm të kuotave, emërimin dhe shkarkimin e administratorit, emërimin e ekspertit kontabël, miratimin e llogarive vjetore dhe të pasqyrave financiare, likuidimin e Shoqërisë, emërimin e likuidatorit.

8.2 Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm do të regjistrohen sipas rendit kronologjik në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose fshihen. Vendimet e paregjistruara në këtë regjistër janë të pavlefshme. Administratori/ët e Shoqërisë janë përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Vendimeve.

Neni 9 - Administrimi i Shoqërisë

9.1 Administratorët e parë të Shoqërisë janë:

a. Znj. Liljana Selimi, shtetase shqiptar, lindur në Poliçan, më 29.06.1974, mbajtëse e letërnjoftimit nr. 036285509, me adresë në: Rr. Nazif Bezhani, Kati.1, Ap.1, Sarandë.

9.2 Administratorët emërohet me vendim të Ortakut të Vetëm dhe do të qëndrojnë në detyrë për një afat 5 vjeçar. Administratorët mund të rizgjidhen për të njëjtin afat në bazë të vendimit të Ortakut të Vetëm ose në përputhje me dispozitat ligjore.

Neni 10 - Ligji i Zbatueshëm

10.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me ligjin shqiptar.

10.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë aktivitetit të Shoqërisë, do të zgjidhet me mirëkuptim, në rast të kundërt mosmarrëveshja do të jetë objekt i zgjidhjes pranë Gjykatës kompetente të Rrethit Gjyqësor.

10.3 Ky Akt Themelimi është hartuar në dy ekzemplarë në gjuhën shqipe, më vlerë të njëjtë secila.

Nënshkruar sot më datë 21. 03 2024.

Znj. Liljana Selimi

Liljana Selimi
